

Ligji i Shtetit të Nju-Jorkut kërkon që drejtuesit e automjeteve të përdorin aksesorët e sigurisë kur drejtojnë mjete motorike që duhet të pajisjen me aksesorë sigurie. Kur një automjet përdoret nga drejtues që ka një leje drejtimi praktikanti të kategorisë DJ, çdo pasagjer në automjet duhet të përdorë një aksesor sigurie (rripin e sigurimit, rripin e sigurimit së bashku me mbajtësen e shpatullave, ndenjësë sigurie për fëmijët).

Nëse keni leje drejtimi praktikanti, do t'i nënshtroheni kufizimeve të mëposhtme:

- ◆ Nuk duhet ta drejtoni automjetin nëse nuk jeni të shoqëruar nga një drejtues mbikëqyrës. Drejtuesi mbikëqyrës duhet të jetë 21 vjeç e lart dhe duhet të ketë licensë të vlefshme për të drejtuar llojin e automjetit që po përdorni. Nëse automjeti është një motoçikletë ose ciklomotor, me ju duhet të udhëtojë vetëm drejtuesi mbikëqyrës. Sidoqoftë, në vend që t'ju shoqërojë në motoçikletë ose ciklomotor, drejtuesi mbikëqyrës mund të ofrojë "mbikëqyrje të përgjithshme" duke ju ndjekur dhe duke qëndruar brenda gjysmë miljeje (400 metrave) larg jush, duke ju vëzhguar gjatë gjithë kohës.
- ◆ Nuk lejohet të drejtoni një automjet që përmban materiale të rrezikshme.
- ◆ Nuk duhet ta drejtoni automjetin në zona që janë caktuar nga DMV-ja si zona për dhënien e provimit të praktikës, përveç se kur kryeni provimin e praktikës.
- ◆ Nuk duhet ta drejtoni automjetin në rrugët e përmendura më poshtë:
 - ❖ Çdo lloj rruge që ndodhet brenda një parku në qytetin e Nju-Jorkut
 - ❖ Çdo lloj ure ose tuneli në qytetin e Nju-Jorkut që është nën juridiksionin e Autoritetit të Urave dhe Tuneleve të Triborough
 - ❖ Rrugët e mëposhtme me peizazh në kontenë Westchester:
 - Hutchinson River Pkwy. - Cross County Pkwy.
 - Saw Mill River Pkwy. - Taconic State Pkwy.

Përveç kufizimeve të listuara më lart, për çdo person që ka një leje drejtimi praktikanti të kategorisë DJ ose MJ zbatohen edhe kufizimet e mëposhtme:

- ◆ Në automjet nuk lejohet më shumë se 1 pasagjer nën 21 vjeç që nuk është pjesëtar i familjes. Kjo nuk zbatohet nëse drejtuesi mbikëqyrës është prindi, kujdestari, mësuesi për formimin e drejtuesve të automjeteve ose instruktori i autoshkollës.
- ◆ I vetmi që lejohet të ulet në ndenjësën e përparme është drejtuesi mbikëqyrës.
- ◆ Nëse drejtoni automjetin në 3 rajonet e treguara në tabelën e mëposhtme, duhet të ndiqni rregullat e përshkruara për secilin rajon:

QYTETI I NJU-JORKUT (TË 5-TA RAJONET)	LONG ISLAND (NASSAU DHE SUFFOLK)	NJU-JORKUT I SIPËRM (TË GJITHA KONTETË E TJERA)
Nga ora 05:00 deri në 21:00	Nga ora 05:00 deri në 21:00	Nga ora 05:00 deri në 21:00
Mund ta drejtoni automjetin vetëm kur jeni në një automjet me komanda të dyfishta (komanda e frenimit e instruktorit) dhe të shoqëruar nga prindi, kujdestari, zëvendësuesi i prindit (loco parentis), mësuesi për formimin e drejtuesve të automjeteve ose instruktori i autoshkollës që është 21 vjeç e lart dhe ka licensë drejtimi të vlefshme për të drejtuar llojin e automjetit që po përdorni.	Mund ta drejtoni automjetin vetëm kur jeni të shoqëruar nga prindi, kujdestari, zëvendësuesi i prindit (loco parentis), mësuesi për formimin e drejtuesve të automjeteve ose instruktori i autoshkollës, që është 21 vjeç e lart dhe ka licensë drejtimi të vlefshme për të drejtuar llojin e automjetit që po përdorni.	Mund ta drejtoni automjetin vetëm kur jeni të shoqëruar nga një person që është 21 vjeç e lart dhe ka licensë drejtimi të vlefshme për të drejtuar llojin e automjetit që po përdorni.
Nga ora 21:00 deri në 05:00	Nga ora 21:00 deri në 05:00	Nga ora 21:00 deri në 05:00
NUK DUHET TA DREJTONI AUTOMJETIN në asnjë rrethanë.	NUK DUHET TA DREJTONI AUTOMJETIN në asnjë rrethanë.	Mund ta drejtoni automjetin vetëm kur jeni të shoqëruar nga prindi, kujdestari, zëvendësuesi i prindit (loco parentis), mësuesi për formimin e drejtuesve të automjeteve ose instruktori i autoshkollës, që është 21 vjeç e lart dhe ka licensë drejtimi të vlefshme për të drejtuar llojin e automjetit që po përdorni.

PËR TË LËNË NJË ORAR PËR PROVIMIN E PRAKTIKËS

Mund ta planifikoni provimin e praktikës në faqen dmv.ny.gov/roadtest ose duke telefonuar Sistemin e automatizuar të Planifikimit të Provimeve të Praktikës në numrin **1-518-402-2100**. Do t'ju kërkohet që të jepni numrin 9-shifror të ID-së në lejen e praktikantit ose licensës dhe numrin e Vërtetimit të Përfundimit të Kursit në certifikatën që morët kur përfunduat kursin prej 5 orësh të sigurisë në autostradë ose kursin e formimit të drejtuesve të automjeteve. Nëse po aplikoni për licensë tregtare drejtimi, do t'ju kërkohet numri që ndodhet në faturën që ju është dhënë kur paguat tarifën e provimit të aftësive.

SHËNIM PËR TË GJITHË ATA QË JANË PAJISUR ME LEJE DREJTIMI PRAKTIKANTI TË KATEGORISË DJ OSE MJ: Para se të kryeni provimin e praktikës, duhet të keni praktikuar minimalisht 50 orë drejtimi në mbikëqyrje, që përfshin të paktën 15 orë drejtimi pas përfundimit të diellit. Në provimin e praktikës duhet të keni me vete formularin e plotësuar MV-262 të DMC-së (vërtetim për drejtimin e automjetit nën mbikëqyrje), tqë ka nënshkrimin e prindit ose kujdestarit tuaj. Formularin mund ta merrni në faqen dmv.ny.gov ose në çdo zyrë të DMV-së, ose mund të telefononi një prej qendrave telefonike të DMV-së dhe të kërkoni formularin.

SHËNIM PËR TË GJITHË PERSONAT E PAJISUR ME LEJE DREJTIMI TREGTARE PRAKTIKANTI (CLP): HYN NË FUQI NGA data 7 shkurt 2022, nëse po aplikoni për herë të parë për një CDL ose për shtimin për herë të parë të një miratimi për materiale të rrezikshme, pasagjerë ose autobus shkolle, duhet të përfundoni trajnimin për drejtim të nivelit fillestar (ELDT) para se të jepni provimin e praktikës CDL. Para se të jepni provimin e teorisë për materialet e rrezikshme kërkohet ELDT-ja për materialet e rrezikshme. Ofruesi i trajnimit duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin e Ofruesve të Trajnimit të FMCSA-së <https://tpr.fmcsa.dot.gov>. Vizitoni seksionin e pyetjeve më të shpeshta në faqen e ELDT-së në <https://dmv.ny.gov/commercial-drivers/entry-level-driver-training-faq> për informacione të mëtejshme rreth kërkesave të ELDT-së.

